




Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë ,27.11.2012

Nr. 0204-1235

PËR: Ali Berisha, Kryetar i Komunës së Pejës
Arbëresha Ajdini Nallbani , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PEJËS NR, 400-8137, 013/7679, 06-7720, 06-7748, të pranuar më datë 16.11.2012,

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimeve, Nr. 400-8137, 013/7679, 06-7720, 06-7748, të miratuar me datë 30.10.2012 nga Kuvendi i Komunës së Pejës, KONFIRMON ligjshmërinë e akteve dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Aktet juridike të listuar të cilat prodhojnë efekt të plotë juridik:

- Vendimi Nr. 400-8137, Aprovohet rritje buxhetore e të hyrave vetanake;
- Vendimi Nr. 013/7679, emërohet komisioni për Koordinimin dhe drejtimin e zgjedhjes së drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësues në komunën e Pejës;
- Vendimi Nr, 06-7720, miratohet propozimi i Komisionit komunal për emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike për emërimi të reja, të rrugëve të pa emëruara;
- Vendimi Nr, 06-7748, Dr, Reshat Pejçinoviç, anëtar i Kuvendit të Komunës së Pejës, nga radhët e subjektit SAD, caktohet anëtar i Komitetit për Politikë e Financa të K.K-Pejë, deri në përfundim të mandatit të kësaj përbërje të Kuvendit, ne vend të anëtarit të këtij komiteti z.Imer Alija, nga subjekti politikë IRDK.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana ,26.11.2012
br. 0204-1235

Za: Ali Berisha, Gradonačelnik Opštine Peć,
Arbëresha Ajdini Nallbani , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës,

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE PEĆ NR, 400-8137, 013/7679, 06-7720, 06-7748, primljeno dana 16.11.2012,

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim prema Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040 , Zakonu br. 03/L-049 o Finansijama Lokalne samouprave, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke, Nr. 400-8137, 013/7679, 06-7720, 06-7748, usvojene dana 30.10.2012 od Skupštine Opštine Peć, POTVRDJUJE zakonitost akata i procenjuje da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu.

Prava akta dole navadena proizvode pune pravne efeke:

- Odluka br, 400-8137, usvaja se budžetsko povećanje sopstvenih prihoda;
- Odluka br, 013/7679, imenuje se komisija za Koordinaciju i rukovodjenje sa izborom direktora školsko obrazovnih institucija i osposobljavanja u Opštini Peć ;
- Odluka br, 06-7720, usvaja se predlog opštinske komisije za imenovanje ulica, puteve i i drugih javnih mesta, za imenovanja neimenovanih ulica ;
- Odluka br, 06-7748, Dr, Rešat Pejćinović, član Skupštine Opštine Peć ,iz redova subjekta SAD, određuje se za člana Odbora za Politiku i Finansije SO Peć , do kraja mandata ovog sastava ,mesto člana ovog Odbora g.Imer Alija, iz političkog subjekta IRDK;

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima uprava i kancelarija
Arhivi MALS-a



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
RAPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 1. pika d) dhe nenit 24. paragrafi 1. të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28.datë: 04.qershor 2008), nenit 2. paragrafi 1. dhe 3. të Ligjit Nr.03/L – 049 Për Financat e Pushtetit Lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.27. date: 03.qershor 2008), nenit 61. Paragrafi 4. Të Ligjit Nr.)3/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. datë:13.mars 2008), nenit 8. dhe nenit 72. të Statutit të Komunës së Pejës, I.Numër: 09 – 8103 datë: 29.Shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 31.tetor 2012, pas shqyrtimit të Rritjes Buxhetore të të Hyrave Vetanake në Komunën e Pejës për vitin 2012, me shumicë votash muar këtë

V E N D I M

I.APROVOHET Rritje buxhetore të të hyrave vetanake e cila duke u bazuar në planin e të hyrave në shumë prej 2,634,920.00 për vitin 2012 kemi përmbushur planin prej 2,260.000.39€ me indeks prej 85,77% në këtë indeks të realizimit perfshihen gjobat në trafik dhe gjobat nga gjykatat të cilat janë pjese e planit. Në bazë të këtij trendi të realizimit aprovohet rritja buxhetore për vitin 2012 në shumë prej 310.000,00€, e rritja buxhetore e mjeteve të Programit të Arsimit në shumë prej 60.000,00 € do të shpërndahet në kategori ekonomike

1. Paga dhe meditje shuma prej 42.000.00€

Arsim dhe shkencë, nënprogrami Arsimi i mesëm (920/94740) në shumë prej 42,000.00 €, në shkollat
Në shkollën e mesme "Ali Hadri" (94744) në shumë prej 27,000.00€, dhe
Në shkollën e mesme "Shaban Spahija" (94741) në shumë prej 15,000.00€, dhe

2. Mallra dhe Sherbime në shumë prej 18,000.00€

Nënprogrami Arsimi i mesëm (920/94740) në shumë prej 18,000.00 €, në shkollat e mesme
Në shkollën e mesme "Shaban Spahija" (94741) në shumë prej 12,500.00€, dhe
Në shkollën e mesme "Gjimnazi Bedri Pejani" (94745) në shumë prej 5,500.00€

II. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në koordinim me Zyrtarin kryesor Financiar.

III.Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Propozimi për Rritje Buxhetore të të Hyrave Vetanake për vitin 2012.

IV.Vendimi ti dërgohet: Kryetarit të Komunës, Zyrtarit Kryesor Financiar të KK.Pejë, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë për Financa dhe një kopje i bashkangjitet procesverbalit nga takimi i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me date: 31.tetor 2012.

I.Numër: 01-400-8137 - 1
Pejë, date: 31.tetor 2012.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PEJËS
KUVENDI KOMUNAL PEJË

KRYESUESJA,
Dr. Arbëresha Ajdini Nallbani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Në bazë të nenit 11, nenit 12 al.1. dhe nenit 30. al.1. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Ligjit Nr.03/L-040 të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28. datë: 04.qershor 2008), nenit 4 paragrafi 1.2, dhe 3 të Udhëzimit Administrativ për procedure e zgjedhjes së drejtorëve të institucioneve edukativo arsimore dhe aftësuese Numër: 3/2009 dt.09.02.2009, dhe nenit 8 të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë: 29 Shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 31.tetor 2012, pas shqyrtimit të propozimit për zgjedhjen e Komisionit për koordinimin dhe zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve edukativo arsimore në Komunën e Pejës, dhe në rekomandim të KPF.-ca, me shumicë votash muar këtë:

V E N D I M

I.Emërohet Komisioni për Koordinimin dhe drejtimin e zgjedhjes së drejtorëve të institucioneve edukativo – arsimore dhe aftësues në komunën e Pejës, në përbërje si vijon:

- 1.Prof. Musa Krasniqi, përfaqësues i Drejtorisë së Arsimit të KK.Pejë,
- 2.Mr. Afërdita Lajçi, anëtare e Kuvendit Komunal Pejë, dhe
- 3.Përfaqësuesi nga MASH.-i.

II.Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi detyrat e tijë do ti kryej konform dispozitave ligjore dhe Udhëzimit Administrativ Numër: 3/2009 datë: 09.02.2009, dhe do ta bën ranglistën e kandidatëve dhe rekomandimin për kryetarin e komunës.

III.Obligohet Komisioni që pas punës së kryer të përgatit një raport informativ mbi punën e tijë për kuvendin komunal.

V.Për zbatimin e këtijë vendimi do të kujdeset Drejtoria e Arsimit të KK. Pejës.

VI.Vendimi ti dërgohet: të emëruarve, Drejtorisë së Arsimit , Ministrisë së Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, dhe një kopje i bashkangjitet Procesverbali nga takimi i mbajtur me datë: 31.tetor 2012.

I.Numër: 01 – 013/7679
Pejë, datë: 31. Tetor 2012.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PEJËS
KUVENDI KOMUNAL PEJË



KRYESUESJA,
Dr.Arbëresha Ajdini Nallbani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
RAPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 17 paragrafi 1 pika o) të Ligjit 03/L – 040
Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28
datë: 04.qershor 2008) dhe nenit 8 dhe nenit 14 paragrafi 1. pika o) të Statutit të Komunës së Pejës,
01.Numër: 09 – 8103 datë: 29 shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë:
31. tetor 2012, pas shqyrtimit të propozimit të Komisionit komunal për emërtimin e rrugëve, rrugicave
dhe vendeve tjera publike, njëzërit muar këtë:

V E N D I M

I.MIRATOHET Propozimi i Komisionit komunal për emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve
tjera publike, për emërim të rreja, të rrugëve të pa emëruara, me emërim si vijon:

1. për emërim rruge me emërin e veteranit të arsimit "Nuredin Basha",
2. për emërim rruge me emërin e luftetarëve për çështje kombëtare dhe dëshmorëve
"Vëllezërit Demë e Rexhë Haxhia",
3. për emërim rruge me emërin e veprimtarit "Tahir Demaj",
4. për emërim rruge me emërin e dijetarit "Abdul Kadër Arnauti", dhe
5. për emërtim rruge me emërin e veprimtarit të mirënjohur "Mulla Zekë Bërdynaj".

II. Për riemërim të lokacionit të quajtur "Përmendorja e Revolucionit Socialist" me emërim të ri
"Memoriali i Pavarësisë", në përkujtim të dëshmorëve, martirëve, intelektualëve dhe
veprimtarëve të komunës së Pejës.

III.Për zbatimin e këtijë Vendimi do të kujdeset: Komsioni për emërtimin e rrugëve, rrugicave
dhe vendeve tjera publike, në bashkëpunim me Drejtorin për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe
Drejtorinë për Punë Komunale dhe Shërbime Publike të KK.Pejë.

IV.Vedimi ti dërgohet: DUMM.-sit, DPKSHP.- ke, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
dhe një kopje i bashkangjitet Procesvrbalit nga takimi i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me datë:
31. tetor 2012.

I.Numër: 06 – 7720/2012

Pejë, date: 31. Tetor 2012.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PEJES
KUVENDI KOMUNAL PEJË



K R Y E S E S J A ,
Dr. Arbëresha Ajdini Nallbani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Në bazë të nenit 11, 51 paragrafi 1. Dhe nenit 52 paragrafi 1. të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04.qershor 2008) dhe nenit 8 të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë: 29.shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 31.tetor 2012, në Kërkesë të subjektit politikë SDA. si dhe bazuar në vendimin mbi themelimin e KPF.-ca ,dhe qendrimin e kuvendit mbi ndryshime me rotacion të anëtarit të komitetit nga radhet e kuvendit që i përkasin komunitetit jo shumicë, njëzërit muar këtë

V E N D I M

I.DR.RESHAT PEJQINOVIQ , anëtar i Kuvendit Komunal Pejë, nga radhet e subjektit politik SAD, caktohet anëtar i Komitetit për Politikë e Financa të KK.Pejë, deri në përfundim të mandatit të kësaj përbërje të kuvendit, në vend të anëtarit të këtijë komiteti z.Imer Alija, nga subjekti politikë IRDK. në bazë të vendimit të kuvendit mbi ndryshimin me rotacion.

II.Në bazë të këtijë vendimi do bëhet edhe kompenzimi shtesë konform nenit 7. Paragrafi 1. të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008 për pagesen e stafit politikë në Komuna.

III.Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet e Financa e KK.Pejë.

IV.Vendimi ti dërgohet: Dr.Rdeshat Pejqinoviç, Kryesuesit të Komitetit për Politikë e Financa,DBF.-ca, MAPL. dhe një kopje i bashkangjitet Procesverbali nga takimi i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me datë: 31.tetor 2012.

I.Numër: 06 – 7748

Pejë, date: 31.tetor 2012.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PEJES
KUVENDI KOMUNAL PEJË



KRYESUESJA,
Dr.Arbëresha Ajdini Nallbani